



## ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01-Nr-016-604

Më datë 06.01.2022

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenin 13, nenit 58, pika (e) lidhur me nenin 60, paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" e duke u bazuar në nenin 30, 45 dhe nenin 48, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të 04.11.2008, nxjerr këtë:

### V E N D I M

#### Për emërimin e nënkryetares të Komunës së Suharekës

1. **Mihrije SUKA** e lindur me 15.10.1958, me vendbanim në lagjen Shirokë, të Suharekës, me profesion ekonomiste, **emërohet Nënkyetare e Komunës së Suharekës.**
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e nënkryetares të Komunës, janë të përcaktuara me Ligjin Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", përkatësisht me nenin 60, të këtij Ligji si dhe me nenin 48, të Statutit të Komunës së Suharekës.
3. Ky emërim fillon nga data **06 janar 2022** dhe i njëjti mandat përfundon me **30.06.2022**, nëse ky emërim nuk ndërpritet më herët.
4. Nënkyetarja, brenda tridhjetë (30) dite nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, është i obliguar të bëjë deklarinimin e pasurisë, në pajtim me nenin 7, të Ligjit Nr. 04/L-050, për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë si dhe deklarinimin pas largimit nga funksioni, brenda afatit tridhjetë (30) ditor, në pajtim me nenin 10, të këtij Ligji, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-228.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari.



**Bali MUHARREMAJ**

Kryetari i Komunës

Kopje:  
Nënkyetares  
Zyra e personelit  
Arkiva